

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7069  
E mërkurë, 13 dhjetor 2023  
Çmimi 0.50 €

Anubhen seancat  
për rastin Thaçi dhe  
të tjerët, gjyqi rifillon më  
15 janar 2024 | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KËTË VIT VLERA E INVESTIMEVE KAPITALE TË REJA NË KOMUNA  
ËSHTË 21.8 MILIONË EURO | FAQE 4-5

## NË NDARJET BUXHETORE QEVERIA KURTI FAVORIZON KOMUNAT QË UDHËHIQEN NGA LV-ja

Instituti GAP ka analizuar ndarjet buxhetore për vitin 2024, duke i krahasuar ato me vitin 2023. Sipas analizës së GAP-it, ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit qeveria ka ndarë më shumë mjete për komunat e udhëhequra nga Vetëvendosja. Ku mbi gjysma e kësaj shume (59.5 % apo 13 milionë euro) janë orientuar në katër komunat e udhëhequra nga LV-ja: Gjilan, Kamenicë, Podujevë dhe Shtime. Përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se ky është diskriminimi më i egër institucional ndaj qytetarëve në historinë e Kosovës që prej çlirimit të vendit tonë. Ndërkaq nga Asociacioni i Komunave të Kosovës kanë theksuar se 22 kryetarë komunash janë ankuar për ndarje jo të drejtë buxhetore

Tabela 1. Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna në vitin 2024

Komuna	Investimet e reja (€)	Investimet e reja (%)	Popullsia (%)	Sipërfaqja (%)	Subjekti Politik*	Investimet për kokë banori
Gjilan	6,300,000€	28.8%	0.0%	3.6%	VV	€85.69
Shtime	2,753,333€	12.6%	1.5%	1.2%	VV	€102.15
Prishtinë	2,300,000€	10.5%	12.3%	4.7%	LDK	€10.50
Kamenicë	2,100,000€	9.6%	1.5%	3.9%	VV	€80.26
Podujevë	1,855,000€	8.5%	4.5%	5.8%	VV	€23.04
Mitrovicë	1,150,000€	5.3%	3.8%	3.0%	PDK	€16.85
Rahovec	1,100,000€	5.0%	3.1%	2.6%	AAK	€19.86
Pejë	1,000,000€	4.6%	5.5%	5.5%	LDK	€19.07
Prizren	900,000€	4.1%	10.9%	5.50%	PDK	€4.64
Lipjan	400,000€	1.8%	3.2%	3.1%	LDK	€6.96
Novobërdë	400,000€	1.8%	0.4%	1.9%	LS	€56.58
Deçan	350,000€	1.6%	2.4%	2.7%	AAK	€8.24
Vushtrri	350,000€	1.6%	3.4%	3.2%	PDK	€5.74
Obiliq	333,500€	1.5%	1.0%	1.0%	IQ për Obiliqin	€19.32
Viti	200,000€	0.9%	2.7%	2.5%	LDK	€4.21
Drenas	185,000€	0.8%	3.4%	2.5%	PDK	€3.05
Mamushë	100,000€	0.5%	0.3%	0.3%	KDTP	€17.21
Suharekë	100,000€	0.5%	3.2%	3.3%	AAK	€1.77

Çështja e shpërndarjes së pabarabartë të fondeve për investime kapitale nga ministrinë në komuna gjithashtu është përmendur edhe në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën. <sup>2</sup>

**REAGIM I KMDLNJ-së:  
INKUIZICIONI I  
GJYKATËS SPECIALE  
VAZHDON, BASTISJE  
DHE ARRESTIME TË  
REJA!** F.3



**HAXHI  
SHALA  
DËRGOHET  
NË HAGË** F.3

**"DIKUSH TË NA SHPJEGOJË SE  
ÇFARË DO TË THOTË KONTRATA":  
VERIU NË DILEMË SE A DO TA  
PAGUAJË RRYMËN** F.8

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SPORT**



**ADEMI: NË JANAR OSE SHKURT  
VENDOSIM PËR TRAJNERIN E RI** F.10

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Policia në Shqipëri sekuestron 500 kilogramë kanabis që kishin destinacion Turqinë

TIRANË, 12 DHJETOR - Rreth 500 kilogramë të bimës kanabis janë sekuestruar të martën nga Policia e Shqipërisë. Aksioni është zhvilluar në qytetin e Vlorës nga policia vendore në bashkëpunim me efektive të Forcës së Posaçme Operacionale dhe të Repartit Special "RENEA" (Reparti i Neutralizimit të Elementëve të Armatosur). Policia ka thënë se shtatë persona të moshave nga 22 deri në 50 vjeç janë

arrestuar. Policia e Vlorës ka thënë se ka zhvilluar disa muaj hetime deri në "goditjen e këtij grupi kriminal". "Këta shtetas vepronin në mënyrë të organizuar për të trafikuar drogën drejt shtetit turk nëpërmjet rrugëve detare. Ata kishin përpunuar dhe ambalazhuar lëndën narkotike në një magazinë dhe, më pas, përmes një automjeti, po e transportonin në afërsi të vijës ujore, për ta

transportuar me rrugë detare drejt Turqisë", ka thënë drejtori i Policisë së Vlorës, Ermal Muçaj. Ai ka thënë se edhe disa persona të tjerë nga Vlora dhe Tirana janë shpallur në kërkim.

Policia ka sekuestruar automjetin e ngarkuar me 34 pako të madhësive të ndryshme me kanabis në formë boçi, me peshë 500 kilogramë.

Operacioni ka vijuar me kontrollin e magazinës në



fshatin Trevllazër, ndërsa zjarri, katër automjete dhe janë sekuestruar dy armë tetë celularë.

## Ukraina has në vështirësi në "fazën e re" të luftës

KIEV, 12 DHJETOR - "Është sikur një gangrenë e cila ka nevojë për mjekim të vazhdueshëm, sepse ndryshe përkeqësohet dhe përhapet", kështu e përshkruan gjendjen e luftimeve në lindje të Ukrainës, Volodymyr, një kirurg në Avdivka, qytetin industrial të Donbasit, i cili është duke u sulmuar pareshur nga ushtria ruse prej fillimit të tetorit.

Ekipi i mjekëve, i cili filloi të punojë këtu pak pasi Rusia e nisi pushtimin e plotë të Ukrainës, e mban një kontejner për plumbat dhe copëzat të cilat i nxjerrin nga trupat e ushtarëve të plagosur.

Prej se Rusia e nisi ofensivën e re në përpjekje për ta rrethuar dhe kapur qytetin strategjik, numri i të plagosurve që janë sjell këtu është rritur - nganjëherë sillen disa dhjetëra ushtarë të lënduar rëndë brenda një dite.

Me afrimin e një dimri tjetër dhe hyrjen e pushtimit rus në vitin e dytë - në një kohë kur e ardhmja e ndihmave ushtarake dhe ekonomike nga Perëndimi për Kievin është e pasigurt për shkak të mosmarrëveshjeve politike, posaçërisht në Shtetet e



Bashkuara, lufta në Ukrainë duket kështu.

Megjithëse është shënuar pak përparim, kundërofensiva e madhe e nisur nga Kievi para gjashtë muajve nuk e ka arritur synimin për ta thyer "urën tokësore" që shtrihet përgjatë Ukrainës jugore, nga Donbasi deri në Krimea, gadishullin e Detit të Zi i cili u kap në vitin 2014 dhe shënoi fillimin e

grabitjes së gjatë dhe të vazhdueshme të tokës nga presidenti i Rosisë, Vladimir Putin.

Në vend se t'i zbrapsin forcat ruse matanë kufirit, ushtarët ukrainas përballen me të vërtetën e vështirë të luftës pozicionale - "një sëmundje e përgjakshme me të cilën jemi mësuar", tha Volodymyr.

Duke e dhënë qëndrimin e vet

për kundërofensivën, komandanti i lartë i ushtrisë së Ukrainës tha se nuk do të ketë "depërtim të shpejtë dhe të bukur". Lufta ka hasur në një "ngecje", tha gjenerali Valeriy Zaluzhnyi për "The Economist". Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i kundërshtoi fjalët e komandantit të lartë, duke thënë se nuk ka ngecje. Por, më 1 dhjetor, ai tha se lufta është futur

në një "fazë të re".

Kur dimri po troket në dyert e Donbasit, ushtarët ukrainas janë të vendosur ta mbrojnë vijën e frontit - e cila, në disa raste, nuk është shumë larg nga ç'ishte kur Rusia e nisi pushtimin, pas gati tetë vjetëve luftimesh në rajon. "Nëse Avdivka bie, atëherë bie", tha Maksym, një ushtar 28 vjeç në këtë rajon, "por ne do të vazhdojmë të luftojmë".

Derisa vendet e BE-së ka shumë pak gjasa t'ia dërgojnë Kievit një milion predhat e premtuara deri në pranverën e vitit të ardhshëm, Rusia është furnizuar me sasi të mëdha të municionit nga Koreja e Veriut dhe e ka rritur prodhimin e vet ushtarak.

Përparësia e Ukrainës në sulme me dronë që e kishte neutralizuar përparësinë e Rosisë në sulme me artileri është shuar tani, tha për REL-in Mykyta, operator i dronëve. Avionët luftarakë F-16 të premtuar nga Perëndimi nuk i janë dorëzuar Ukrainës ende, prandaj Rusia vazhdon ta mbizotërojë hapësirën ajrore mbi vijën e frontit.

## Zelensky e nis vizitën në ShBA me lutje për ndihma ushtarake

UASHINGTON, 12 DHJETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, e nisi ditën e parë të vizitës në Uashington më 11 dhjetor me një lutje për liderët ushtarakë të Shteteve të Bashkuara për ndihma shtesë për vendin e tij të rrethuar, duke u thënë atyre se "ne nuk do të dorëzohemi" në luftën kundër pushtimit nga presidenti i Rosisë, Vladimir Putin. "Putini duhet të humbë patjetër. Ne e dimë çfarë duhet të bëjmë. Ju mund të llogarisni në Ukrainën, dhe ne shpresojmë njëjtë se do të mund të llogarisim në juve", tha

Zelensky gjatë një takimi në Universitetin e Mbrojtjes Kombëtare në Uashington.

Sekretari amerikan i Shtetit, Lloyd Austin, i premtoi mbështetje të palëkundur Kievit dhe paralajmëroi se Putini ende shpreson në fitore në luftë kundër Ukrainës me gjithë humbjet e mëdha të Kremlinit në konfliktin që nisi në shkurt 2022. "Me gjithë krimet dhe izolimin, Putini ende beson se ai mund ta mposhtë Ukrainën dhe se mund ta mposhtë Amerikën. Por, ai e ka gabim. Përkushtimet e Amerikës duhet të nderohen",

tha Austin, teksa administrata e presidentit amerikan Joe Biden po ka vështirësi ta bindë opozitën republikane për t'i vazhduar mbështetjet për Kievin.

Bideni e ftoi Zelenskyn në Uashington për ta rikonfirmuar mbështetjen e administratës së tij për Kievin në një kohë mosmarrëveshje me republikanët në Kongres, të cilët i kanë bllokuar ndihmat ushtarake dhe ekonomike për Ukrainën në vlerë dhjetëra miliarda dollarë. Ai do ta mirëpresë liderin ukrainas në Shtëpinë e Bardhë më 12 dhjetor, tha



zëdhënësja Karine Jean-Pierre.

Zelensky do t'u drejtohet edhe senatorëve amerikanë

dhe do të takohet edhe me kryetarin e ri republikan të Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson.

Reagim i KMDLNj-së

# Inkuizicioni i Gjykatës Speciale vazhdon, bastisje dhe arrestime të reja!

Më 11 dhjetor persona të pidentifikuar në Banjë të Malishevës bastisën shtëpinë e luftëtarit të UÇK-së dhe më vonë deputetit të Kuvendit të Kosovës, Haxhi Shala të cilin e dërguan në bazën burg të EULEX-it për ta marrë në pyetje. Kohë më parë i kishin konfiskuar telefonin. Haxhi Shala, i privuar nga liria natën e kaloi në bazën burg të EULEX-it, pa u informuar nga askush ai dhe familja e tij për fatin e tij. Dyshimet janë se sot do të dërgohet në Burgun e Gjykatës Raciste Speciale në Hagë ku po mbahen peng edhe 8 ushtarë të UÇK-së disa prej të cilëve në çastin e arrestimit ishin bartës të posteve më të larta politike dhe institucionale të Kosovës. Sipas informatave të KMDLNj-së, paramilitarët e Gjykatës Speciale që nuk kanë shenja identifikuese po tregohen të kujdesshëm gjatë bastisjeve për të krijuar një përshtypje se po i respektojnë standardet ligjore dhe të drejtave të njeriut gjatë këtyre inkursioneve kundër ushtarëve të UÇK-së dhe përkrahësve të tyre. Gjatë bastisjeve i pranishëm është edhe avokati të cilin e propozon i dyshuari. Është mbase jo vetëm coincidençë e rastit edhe kërcënimi që gjatë vizitës së fundit në Prishtinë e shpërndaui Ekaterina Trandafilova, kryetare e parapaguar e kësaj Gjykate se Hashim Thaçi, president i Kosovës, Jakup Krasniqi për dy mandate kryetar i Kuvendit, Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit dhe Rexhep Selimi, shef i GP të LVV-së mund të dënohen me burg të përjetshëm dhe se bastisjet dhe aksionet tjera inkursuese do të vazhdojnë edhe në të ardhmën. Ky kërcënimi mbase u sfocua edhe pas takimit publik me disa



ambasadorë sikur edhe pas takimit me disa udhëheqës politikë kosovarë e që takimet nuk u bënë publike. Kërcënimet i vazhdoi edhe pasi u kthye në Hagë pas së cilës ishin tre bastisje dhe një arrestim, ky i Haxhi Shalës. Sipas informatave të KMDLNj-së nga terreni pakënaqësitë me këto bastisje nga persona të pidentifikuar dhe të panjohur në kohën kur kjo Gjykatë policët e Kosovës i angazhon si "punëtorë krahu" për të rregulluar trafikun dhe për të krijuar përshtypje krejtësisht mashtruese se edhe Policia e Kosovës është pjesë aktive e këtij inkuizicioni përndjekës është në rritje dhe mund të dalë jashtë kontrollit. Arsyetimi i kësaj Gjykate për arrestime dhe bastisje është "pengimi i administrimit të

drejtësisë" paraqet carta bianca për veprime të pakufizuara dhe të pakontrolluara nga askush e, më së paku nga institucionet e Kosovës që nominalisht janë themelues të kësaj Gjykate. Në kohën e regjimit të ish-Jugosllavisë, UDB-ja serbe dhe jugosllave kishte shpikur një nen inkriminues që sanksiononte fjalën e lirë dhe lirinë e mendimit duke dënuar me burg të rëndë, prej 1 deri më 10 vjet të gjithë ata që flisnin për lirinë e shqiptarëve apo edhe që mendonin se duhet të jenë të barabartë me të tjerët. Ky nen ishte aq fleksibili sa krijonte mundësi të pakufishme për të burgosur, rrahur, vvarë dhe dënuar shqiptarë që e donin lirinë, qoftë edhe si ide, pa e ndërmarrë asnjë veprim konkret. Gjykata Speciale Raciste po e përdorë të njëjtën metodë që e ka

zbatuar UDB-ja përmes ligjit për pengim të administrimit të drejtësisë mund të bastisë dhe arrestojë të gjithë ata që nuk duan të bëhen dëshmitarë, që përkrahin luftën e UÇK-së apo që nuk pajtohen me këtë Gjykatë. Mjafton që ndonjë dëshmitar i mbrojtur ta përmend emrin dhe paramilitarët e Speciales do t'i keni në shtëpi. Gjykata Speciale po përdorë dëshmitarë me dëshmi të sajua, informatorë të BIA-së serbe dhe dëshmitarë të rekrutuar nga sigurimi serb, dëshmitarë të prokurorisë serbe dhe dëshmitarë nga Kosova të joshur me shumë përfitime, para, ndryshim të identiteti dhe strehim në një vend tjetër. KMDLNj denoncon publikisht këto kërcënime nga kryetarja Trandafilova si shkelje të drejtave të njeriut të personave të

privuar nga liria e që po mbahen në Hagë për faktin se në mënyrë flagrante po e shkelë parimin e prezumimit të pafajësisë pasi i shpallë fajtorë të akuzuarit, ende pa përfunduar procesi gjyqësor. KMDLNj denoncon botërisht sajimin e përgjimeve ndaj pengjeve që po mbahen në Hagë, të gjithë shtetas të Kosovës dhe të gjithë shqiptarë pas së cilave, me propozim të PS ndaj tyre janë marrë masa represive si ndalimi i vizitave të paprivileguara dhe bisedave telefonike. KMDLNj denoncon publikisht deputetët e Kuvendit të Kosovës që nuk kërkojnë raport nga kjo Gjykatë për respektimin dhe shkeljen e identifikuar të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria pasi po ky Kuvend ka votuar themelimin e kësaj gjykate.

## Haxhi Shala dërgohet në Hagë



PRISHTINË, 12 DHJETOR - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Haxhi Shala, është dërguar të martën në Hagë, në të cilën gjendet selia e Gjykatës Speciale të Kosovës. Lajmin për "Radion Evropa e Lirë" e ka konfirmuar avokati i Shalës, Xhevdet Smakiqi. "E konfirmojmë që sot në mëngjes [Haxhi Shala] është dërguar [në Hagë]". Ai ka thënë se aktualisht Shala dyshohet për pengim të drejtësisë. Haxhi Shala është intervistuar të hënën në zyrat e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX) në Fushë-Kosovë. Të njëjtën ditë janë zhvilluar bastisje në shtëpinë e tij në fshatin Banjë të Malishevës. Së fundi, Specialja e ka

arrestuar edhe ish-kryetarin e Malishevës, Isni Kilaj, nën dyshimin për pengim të drejtësisë. Ndërkaq në muajin tetor janë arrestuar dhe transferuar në objektin e paraburgimit në Hagë edhe Sabit Januzi dhe Ismet Bahtjari, të cilët, sipas Speciales, "akuzohen për frikësim dhe tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përfshirë përmes kërcënimit të rëndë". Gjatë këtij viti Specialja ka kryer disa herë bastisje në Kosovë. Pa dhënë shumë detaje, prokuroria në Hagë kishte bërë me dije se operacionet janë zhvilluar në një proces hetimor që përqendrohet në vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Tabela 1. Investimet e reja kapitale nga niveli qendror në komuna në vitin 2024

Komuna	Investimet e reja (€)	Investimet e reja (%)	Popullsia (%)	Sipërfaqja (%)	Subjekti Politik*	Investimet për kokë banori
Gjilan	6,300,000€	28.8%	0.0%	3.6%	VV	€85.69
Shtime	2,753,333€	12.6%	1.5%	1.2%	VV	€102.15
Prishtinë	2,300,000€	10.5%	12.3%	4.7%	LDK	€10.50
Kamenicë	2,100,000€	9.6%	1.5%	3.9%	VV	€80.26
Podujevë	1,855,000€	8.5%	4.5%	5.8%	VV	€23.04
Mitrovicë	1,150,000€	5.3%	3.8%	3.0%	PDK	€16.85
Rahovec	1,100,000€	5.0%	3.1%	2.6%	AAK	€19.86
Pejë	1,000,000€	4.6%	5.5%	5.5%	LDK	€19.07
Prizren	900,000€	4.1%	10.9%	5.50%	PDK	€4.64
Lipjan	400,000€	1.8%	3.2%	3.1%	LDK	€6.96
Novobërdë	400,000€	1.8%	0.4%	1.9%	LS	€56.58
Deçan	350,000€	1.6%	2.4%	2.7%	AAK	€8.24
Vushtrri	350,000€	1.6%	3.4%	3.2%	PDK	€5.74
Obiliq	333,500€	1.5%	1.0%	1.0%	IQ për Obiliqin	€19.32
Viti	200,000€	0.9%	2.7%	2.5%	LDK	€4.21
Drenas	185,000€	0.8%	3.4%	2.5%	PDK	€3.05
Mamushë	100,000 €	0.5%	0.3%	0.3%	KDTP	€17.21
Suharekë	100,000€	0.5%	3.2%	3.3%	AAK	€1.77

Çështja e shpërndarjes së pabarabartë të fondeve për investime kapitale nga ministritë në komuna gjithashtu është përmendur edhe në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën.<sup>2</sup>

KËTË VIT VLERA E INVESTIMEVE KAPITALE TË REJA NË KOMUNA ËSHTË 21.8 MILIONË EURO

## Në ndarjet buxhetore qeveria Kurti favorizon komunat që udhëhiqen nga LV-ja

Instituti GAP ka analizuar ndarjet buxhetore për vitin 2024, duke i krahasuar ato me vitin 2023. Sipas analizës së GAP-it, ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit qeveria ka ndarë më shumë mjete për komunat e udhëhequra nga Vetëvendosja. Ku mbi gjysma e kësaj shume (59.5 % apo 13 milionë euro) janë orientuar në katër komunat e udhëhequra nga LV-ja: Gjilan, Kamenicë, Podujevë dhe Shtime. Përfaqësuesit e opozitës kanë theksuar se ky është diskriminimi më i egër institucional ndaj qytetarëve në historinë e Kosovës që prej çlirimit të vendit tonë. Ndërkaq nga Asociacioni i Komunave të Kosovës kanë theksuar se 22 kryetarë komunash janë ankuar për ndarje jo të drejtë buxhetore

në Bruto Produktin Vendor ka një trend rënës nga viti 2017, dhe në vitet 2021 dhe 2022 ka mbetur e pandryshuar, në nivel prej 8 %. Për më shumë, shkalla e realizimit të buxhetit të ndarë për investime kapitale mbetet e ulët, në nivel 60 % në vitin 2022 dhe në nivel 35 % deri në shtator të vitit 2023. Këtë vit vlera e investimeve kapitale të reja të nivelit qendror të destinuar për projekte specifike në komuna është 21.8 milionë euro”, thuhet në këtë analizë.

Sipas analizës së GAP-it, ngjashëm me vitin e kaluar, edhe këtë vit qeveria ka ndarë më shumë mjete për komunat e udhëhequra nga Vetëvendosja. Mbi gjysma e kësaj shume (59.5 % apo 13 milionë euro) janë orientuar në katër komunat e udhëhequra nga LV-ja: Gjilan, Kamenicë, Podujevë dhe Shtime. Këto komuna përbëjnë 14.5 % të sipërfaqes në Kosovë dhe 11.6 % të popullsisë. “Në projektbuxhetin e vitit 2024 parashihen 14.5 milionë euro më shumë për sektorin e drejtësisë. Përkundër një rritjeje të buxhetit

për shëndetësi prej 42 milionë eurosh dhe për arsim për mbi 54 milionë euro në vitin 2024, shpenzimet e Kosovës për kokë banori në këta sektorë mbesin të ulëta”, thuhet në këtë analizë.

**Krasniqi: Kjo qasje e qeverisë kundër qytetarëve të komunave që nuk i drejton është shantazh i ulët politik**

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se derisa për katër komunat që udhëhiqen nga Lëvizja Vetëvendosje, qeveria ka ndarë më shumë se gjysmën e buxhetit për investime të reja kapitale për vitin 2024, për katër komuna që udhëhiqen nga Partia Demokratike e Kosovës - Ferizajn, Skenderajn, Kaçanikun e Hanin e Elezit, nuk ka ndarë asnjë cent. “Gjilani, Shtimja, Kamenica dhe Podujeva përbëjnë 11.6 % të popullsisë së Kosovës, ndërsa u është ndarë 59.5 % e buxhetit për investime të reja kapitale. Ndërkaq, për të

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka aprovuar Projektbuxhetin 2024 më 31 tetor 2023, ndërsa Kuvendi e ka aprovuar në lexim të parë më 16 nëntor 2023. Instituti GAP ka analizuar ndarjet buxhetore për vitin 2024, duke i krahasuar ato me vitin 2023. Sipas GAP-it, në hartimin e projektbuxhetit të vitit 2024 qeveria është treguar më e matur në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve për shkak që parashikohet një rritje e ngadalësuar e të hyrave dhe

shpenzimeve buxhetore, me 5 % dhe 3 % respektivisht, duke arritur në shumën 3 miliardë euro dhe 3.3 miliardë euro. “Shpenzimet kapitale planifikohen të rriten më shumë sesa ato rrjedhëse, megjithatë rritja e planifikuar e tyre është relativisht e ulët krahasuar me vitin paraprak (15 %). Te kategoritë kryesore të shpenzimeve rrjedhëse, kategoria e pagave dhe shtesave planifikohet të ketë rritje prej 59.9 milionë eurosh apo 8 %, kryesisht për shkak të rritjes së vlerës monetare të koeficientit të pagave të sektorit publik nga 105

në 110 euro. Me Projektbuxhetin 2024 është krijuar hapësirë edhe për 2 308 vende pune shtesë, nga të cilat 1 793 për nivelin qendror (kryesisht në Ministrinë e Punëve të Brendshme (polici) dhe atë të Mbrojtjes (FSK) dhe 515 për nivelin komunal”, thuhet në këtë analizë të GAP-it. Më tej theksohet se nga gjithsej 859.2 milionë euro sa janë planifikuar për shpenzime kapitale për vitin 2024, rreth 83 % janë vazhdim i projekteve të mëhershme dhe 17 % janë planifikuar për projekte të reja kapitale. “Pjesëmarrja e buxhetit të ndarë për investime kapitale

# Abdixhiku nis vizitën dyditore në Parlamentin Evropian

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka nisur vizitën dyditore në Parlamentin Evropian në Strasburg. "Vizitën e nisa me pjesëmarrje në ndezjen e qirinjeve dhe dritave të Krishtlindjes, organizuar nga presidentja e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola. Atë e falënderova për mbështetjen që kjo shtëpi evropiane e demokracisë i ka dhënë në të gjitha etapat historike Republikës së Kosovës. Njëkohësisht i shpreha nevojën që në këtë periudhë të zhvillimeve përcaktuese në kontinent, ky institucion ta ketë Kosovën dhe popullin e Kosovës në qendër të zhvillimeve në Ballkan", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ai ka theksuar se në këtë vizitë ishte pjesëmarrës edhe në

punimet e grupit të eurodeputetëve të EPP-së, grupit më të madh politik në Parlamentin Evropian. "Aty takova edhe kryetarin e EPP-së, z. Manfred Weber; të cilin e njoftova për organizmin tonë të brendshëm partiak dhe konventën e madhe programore 'Rruga e Re'. EPP do ta mbështesë LDK-në me të gjitha potencialet e saj. Në fund të ditës së parë, nën organizimin e eurodeputetit Lukas Mandl, isha pjesëmarrës në debatin e organizuar në trevjetorin e njohjes reciproke Kosovë - Izrael. Në panel prezantova pikëpamjet e Lidhjes Demokratike të Kosovës mbi sigurinë tonë kombëtare, të drejtës e mbrojtjes dhe domosdoshmërinë e mbështetjes së aleatëve. E ardhmja jonë është Evropa", ka theksuar Abdixhiku.



## Latifi thotë se do të angazhohet për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc

Rahovec, 12 dhjetor - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në të martën në takim kryetarin e Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi, Nevzad Lutfiu, me të cilin ka biseduar për shqetësimet dhe nevojat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, për padrejtësitë e mëdha dhe diskriminimin sistematik që u bëhet atyre nga shteti dhe institucionet qendrore dhe lokale të Serbisë.

Latifi ka bërë me dije se në këtë takim ka shprehur gatishmërinë që bashkërisht të kujdesemi dhe të përpiqemi për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave që po u shkelen shqiptarëve në këtë pjesë. "Kënaqësi e veçantë të pres në një takim të përzemërt dhe vëllazëror, z. Nevzad Lutfiun, kryetarin e Këshillit Kombëtar të Shqiptarëve, që jetojnë në trojet e veta autoktone, ku



padrejtësisht dhe dhunshëm vazhdojnë t'u mohohen dhe shkelen të drejtat kombëtare dhe ato individuale nga Serbia. Me z. Lutfiu folëm për shqetësimet dhe nevojat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, për padrejtësitë e mëdha dhe diskriminimin sistematik që u bëhet atyre nga shteti dhe institucionet qendrore e lokale të Serbisë. Shpreha gatishmëri që bashkërisht të kujdesemi dhe të përpiqemi për mbrojtjen e qenies sonë kombëtare, për realizimin e të drejtave që po u shkelen, për ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës, të artit, të kulturës dhe të identitetit shqiptar, si dhe për kthimin e tyre në trojet e veta. E përgëzoj z. Lutfiu për kontributin dhe angazhimin e palodhshëm, si dhe i uroj punë të mbarë!", ka thënë pas takimit kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi.

gjithë të tjerët, që janë 88.4 % e popullsisë, qeveria ka ndarë vetëm 40.5 % të këtij buxheti. Ky është diskriminimi më i egër institucional ndaj qytetarëve në historinë e Kosovës që prej çlirimit të vendit tonë", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Ai ka thënë se kultura politike në Kosovë ka nevojë të shtensionohet e të rritet bashkëpunimi, jo të instalohet kjo kulturë e hakmarrjes dhe diskriminimit. "Kjo qasje e qeverisë kundër qytetarëve të komunave të cilat nuk i drejton partia në pushtet është shantazh i ulët politik. I ftoj edhe deputetët e Vetëvendosjes, krahas atyre të opozitës, që me votën e tyre të mos e vulosin këtë propozim diskriminues të qeverisë. Është e turpshme dhe e papranueshme të votohet për një buxhet të tillë", ka thënë Krasniqi.

### Smajl Latifi: Jemi të pakënaqur me ndarjen buxhetore, qeveria u soll jomiqësore me Rahovecin

Kryetari i Rahovecit që vjen nga radhët e AAK-së, Smajl Latifi, është shprehur i pakënaqur në lidhje me projektligjin e qeverisë Kurti për ndarje buxhetore në lidhje me komunën që udhëheq ai. "Edhe ne jemi të pakënaqur me projektligjin për ndarje buxhetore, për faktin që ndaj komunave, ndaj shumicës së komunave të Republikës së Kosovës, ka një sjellje absolutisht jomiqësore, që të mos themi tani armiqësore, sikur komunat e Republikës së Kosovës 22 sosh mos të ishin fare komuna që janë asete të këtij shteti", ka thënë Latifi në "InfoMagazine" të "Klan Kosovës".

Më tutje, ai tha se pakënaqësia e tij vjen për shkak se kërkesat që i kanë dërguar qeverisë kanë qenë të rregullta dhe me interes për komunën dhe qytetarët e komunës së Rahovecit. "Komuna e Rahovecit ka diçka në planin për investimet e vitit 2024 nga ana e qeverisë, mirëpo absolutisht jam i pakënaqur për faktin se ne kemi dërguar në vazhdimësi dhe në mënyrë të rregullt, me kohë, kërkesat e qarta të artikuluara dhe me interes të madh edhe jetik dhe të domosdoshme për komunën tonë dhe për qytetarët e komunës tonë", është shprehur Latifi. "Bëhet fjalë për kërkesa për projekte investive të cilat nuk janë në kapacitetet e komunës së Rahovecit, nuk mund të mbulohen financiarisht nga komuna e Rahovecit, kemi kërkuar financim drejtpërdrejt ose kemi kërkuar të jemi

bashkëfinansues me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht me ministritë e linjës, ose kemi kërkuar që të buxhetohen ato projekte që financohen direkt", ka pohuar Latifi.

### AKK-ja: Shumica e kryetarëve që nuk vijnë nga LV-ja ankohen...

Përfaqësues të Asociacionit të Komunave të Kosovës kanë theksuar se 22 kryetarë komunash janë ankuar për ndarje jo të drejtë buxhetore. Sipas tyre, ministritë e linjës, siç është ajo e Shëndetësisë, Arsimit, Infrastrukturës dhe MAPL-ja, kanë vendosur kriteret politike për të përfituar nga buxheti i qeverisë gjë që po shkakton vështirësi për komunat të cilat udhëhiqen nga partitë opozitare. "Nuk është hera

e parë që kryetarët e komunave aludojnë në këso dallime. Shumica e kryetarëve që nuk vijnë nga LV-ja ankohen. Tash kemi rastin kur ndahen mbi 100 milionë euro nga ministritë e linjës dhe ato i vendosin vetë kriteret e veta pa konsulta me komuna dhe pastaj kryetarët e komunave aludojnë se po përdoren kriteret politike. Si zgjidhje duhet të ndahet granti i katërt në mënyrë që të mos ketë këso ankesa", ka thënë Sazan Ibrahim, drejtor i Asociacionit të Komunave të Kosovës. Lidhur me kritikën e vazhdueshme ndaj Qeverisë së Kosovës për mungesë të investimeve kapitale dhe bartje të buxhetit nga viti në vit, profesori i ekonomisë, Muhamet Sadiku, thotë se pa investime në komuna nuk mund të ketë zhvillim ekonomik.

## Veprimtari Bislimi merr pjesë në Konferencën e Paqes për Lindjen e Mesme në Charleroi të Belgjikës

CHARLEROI, 12 DHJETOR - Drejtori i "Zërit Perëndimor të Kosovës", Sali Bislimi, ka marrë pjesë në Konferencën e organizuar në Charleroi të Belgjikës për Paqen në Lindjen e Mesme nga parlamenti belg, Denis Ducarme. Me këtë rast, Bislimi pati takime me ish-komisionarin evropian Louis Michel dhe ish-ministër i Jashtëm i Belgjikës, presidentin aktual të Këshillit Evropian, Charles Michel, kryetarin e Lëvizjes Reformatore Liberale, senatorin Georges Luis Bouchez. "Miku im, Denis Ducarme parlamenti belg, me ftoi në

parlament ku do të me ofroi mbështetje në të gjitha format e mundshme për Kosovën. Unë do ta paraqesë edhe një rezolutë për Specialen tek parlamentarët belg për të kërkuar drejtësi dhe paanshmëri Gjykatës Speciale selektive antishqiptare në Hagë! Shtrova edhe shume çështje për Kosovën, ku besoj se së shpejti do t'i shpalosi në parlamentin belg. Kontributi për Kosovën, UÇK-në dhe prezantimi i vlerave perëndimore të Kosovës me jep shpresë dhe jetë!", ka shkruar Bislimi në "Facebook".



## Gjashtë komuna arrijnë marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunale

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Komuna e Prishtinës, e Podujevës, e Lipjanit, e Obiliqit, e Fushë-Kosovës dhe e Graçanicës kanë arritur marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunale në të mirën e qytetarëve të këtyre komunave. Lajmin e ka dhënë kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama. "Bashkëpunimi mes Prishtinës dhe pesë komunave tjera për të mirën e qytetarëve tanë, u vulos sot me nënshkrimin e marrëveshjes me kryetarët e Podujevës, z. Shpejtim Bulliqi, atë të Lipjanit, z. Imri Ahmeti, z. Xhafer Gashi të Obiliqit dhe nënkryetarët e Fushë Kosovës, z. Besnik F Osmani dhe z. Leutrim Ajeti të Graçanicës. Përmes kësaj marrëveshjeje ndërkomunale ne do të bashkërendojmë



aktivitetet tona në fushat e menaxhimit të mbeturinave, qenve endacakë dhe transportit publik, me anë të cilave do të krijohen lehtësira për mirëqenien e qytetarëve të kryeqytetit dhe këtyre komunave", ka shkruar Rama në "Facebook".



## Ish-deputetja Ismaili: Kurti ka vënë interesat e partisë mbi mirëqenien e vendit

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Ish-deputetja e PDK-së, Besa Ismaili, ka theksuar se kryeministri Albin Kurti edhe tani ka vënë interesat e partisë mbi mirëqenien e vendit që ai duhet të përfaqësojë. Sipas saj, në qasjen e tij për pushtet dhe kontroll, ai ndjek një qasje tribaliste, duke konsideruar aleatë partitë e së majtës socialiste evropiane, ndërsa partitë e opozitës së Kosovës jo vetëm si kundërshtarë ideologjikë, por edhe si armiq të vendit. "Tani që shtetin e Kosovës e ka vendosur nën masa ndëshkimore nga Bashkimi Evropian, e për ç'gjë nuk shohim asnjë përpjekje nga ana e tij për heqjen e tyre, ajo çfarë shohim nga vizita e tij në Evropë këto ditë nëpër kongrese e mexhlise të partive të majta, shpërfaq fytyrën reale të Kurtit të përqendruar vetëm te përfitimet afatshkurtra për partinë e tij, në vend të

zgjidhjeve afatgjata për vendin", ka shkruar Ismaili në "Facebook".

Ajo ka shtuar se prioretizimi i partisë mbi Kosovën për të parin e Qeverisë së Kosovës dëshmon mungesën e aftësisë dhe vullnetit të tij për t'i adresuar sfidat komplekse me të cilat po përballet Kosova. "Ilustrative për këtë fakt flasin edhe takimet e Kurtit me bizneset e diasporës dhe anashkalimi dhe shtypja që ai ua bënë bizneseve në vend. Peshorja politike e Kurtit që kualifikon për mbështetje dhe bashkëpunim qëndron mbi kriterin: nëse kontribuoni për LV-në, jeni të mirë për Kosovën. Por, jo edhe anasjelltas: kush kontribuon për Kosovën, është i/e mirë edhe për Kurtin dhe partinë e tij. Dhe pikërisht ky kriter është diskualifikues për burrështetas dhe mallkues për shtetin", ka theksuar ish-deputetja Ismaili.

## Hani i Elezit, mijëra fidanë të pishave po mbillen në Kodrën e Shullanit

HANI I ELEZIT, 12 DHJETOR - Komuna e Hanit të Elezit ka organizuar aksion vullnetar për mbjelljen e fidanëve të pishave në Kodrën e Shullanit në Seçishtë. Deri tani janë mbjellë mbi 11 mijë fidanë, ndërsa ky aksion do të vazhdojë deri në pyllëzimin e tërësisë të Kodrës së Shullanit me 35 mijë fidanë. "Falënderojmë punëtorët e pandalshëm të NPL 'Pastrimit', që edhe sot ishin pjesë e aksionit vullnetar të mbjelljes së fidanëve të pishës, por edhe të tjerët që



ditën e sotme ia kushtuan këtij aktiviteti", është shprehur kryetari i Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi.

## Osmani udhëton për në Bruksel për Samitin e Liderëve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor



PRISHTINË, 12 DHJETOR - Me ftesë të presidentit të Këshillit Evropian, Charles Michel, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Bruksel, ku do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në Samitin e Liderëve të Bashkimit Evropian dhe Ballkanit

Perëndimor. Në takimin e liderëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor presidentja Osmani do të diskutojë për nevojën e përshejtit të procesit të integritetit në dritë të sfidave të vazhdueshme të sigurisë në rajon dhe më gjerë, duke filluar me mbështetjen për

statusin e vendit kandidat për Republikën e Kosovës. Liderë të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Bruksel, ndër të tjera, do të diskutojnë për procesin e zgjerimit dhe perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, bashkërendimin me politikën e përbashkët të

jashtme dhe të sigurisë të BE-së si dhe për tejkalimin e sfidave të përbashkëta. Në kuadër të samitit, Osmani, po ashtu, do t'i informojë krerët e shteteve dhe të BE-së lidhur me situatën e sigurisë në vend pas sulmit të agresionit të Serbisë më 24 shtator.

## Kurti diskuton me donatorët për strehimin e përhershëm të 60 familjeve të komuniteteve joshumicë

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i ka falënderuar të martën donatorët që janë ofruar për të ndihmuar në gjetjen e një strehimi të përhershëm për 60 familje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas. Kurti ka thënë se këto familje janë kthyer në Kosovë prej Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi dhe kanë jetuar në kushte të rënda. Ata janë strehuar përkohësisht në Obiliq. "Ka qenë viti i kaluar kur e kam parë fotografinë e njëjës prej familjeve në rrjetet sociale. Ata janë kthyer në Kosovë, por pa strehim. Në vend të shtëpisë, ata e kanë krijuar në tendë të improvizuar në një tokë bujqësore. Fëmijë e të rritur kanë tentuar të bëjnë gjithçka për të jetuar me dinjitet", ka thënë Kurti në konferencë. Ai i ka falënderuar aktivistët e



shoqërisë civile që i kanë dhënë vëmendje këtij rasti. Mes të tjerash, Kurti ka thënë se këto familje kanë përfituar nga paketa e ndihmës, e ofruar prej

Ministrit për Komunitete dhe Kthim, dhe në këtë çështje ka qenë e përfshirë edhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. "Situata shpesh mund të

jetë edhe e komplikuar edhe e thjeshtë. Fakti se si ky grup i familjeve kishte rënë në këtë situatë, kishte të bënte me përgjegjësi ndërkombëtare,

shtetërore dhe lokale", ka thënë Kurti.

Në nisje të diskutimeve për gjetje të strehimit të përhershëm për këto familje, ambasadori britanik në Kosovë, Nicholas Abbott, i ka falënderuar komunën e Ferizajt dhe të Gjilanit që kanë shprehur gatishmëri për të ndarë tokë për ndërtim të shtëpive për këto familje.

Abbott ka bërë thirrje që të ndihmohen të gjithë personat që dëshirojnë të kthehen në Kosovë, "të kenë qasje në shëndet, arsim dhe që procesi i integritetit të jetë sa më i lehtë". Sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2011, në Kosovë jetojnë 8 824 romë, 15 436 ashkalinj dhe 11 524 egjiptas.

Agjencia e Statistikave e Kosovës nuk ka të dhëna për nivelin e edukimit të këtyre komuniteteve.

## Hoti: Asnjë avancim në prokurimin publik gjatë vitit 2023

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se asnjë avancim nuk është bërë në prokurimin publik gjatë vitit 2023. Sipas tij, përkundrazi, prokurimi publik është karakterizuar me bllokadë në shqyrtimin e lëndëve, tejkallim të afateve ligjore në shqyrtim të lëndëve, diskriminim ndaj operatorëve, ndryshim joligjor të rregullores së punës dhe mungesë transparence në shqyrtimin e ankesave.

Hoti ka paraqitur dhjetë vërejtjet kryesore nga monitorimi i punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit gjatë vitit 2023. "1. Në OShP janë deponuar 748 ankesa nga operatorët, por vetëm 23% e tyre janë zgjidhur brenda afatit ligjor. 2. Për 116 ankesa, ka skaduar afati ligjor për shqyrtim. 3. Koha mesatare e zgjidhjes së ankesave është rritur nga 55 ditë, sa ka qenë më herët, në 63 ditë për vlerën e lëndëve të ankesave deri



në 300,000.00 euro. 4. OShP përdorë standarde të dyfishta të shqyrtimit të ankesave, pasi Bordi kishte vendosur që të mos trajtoheshin ankesat të cilave u

kishte skaduar afati ligjor për shqyrtim, ndërkaq sot pjesa dërrmuese e vendimeve janë të nxjerra jashtë afatit ligjor. 5. Për një kohë të caktuar nuk ka

funksionuar Bordi i OShP-së, duke dëmtuar të drejtat e operatorëve dhe bllokuar investimet publike", ka shkruar Hoti në "Facebook". Ai ka thënë se vërejtja e 6 është se

shoqëria civile e ka të pamundur t'ë monitorojë si duhet aktivitetet e OShP-së. "7. OShP dy herë kishte ndryshuar rregulloren e punës. Fillimisht kishte vendosur që ankesat për kontratat në vlerë deri në 100,000 euro të shqyrtoheshin në panele individuale. Pastaj, ky prag është rritur në 300,000 euro. Në rregulloren e mëparshme të punës së OShP-së, ky prag ka qenë 30,000 euro. Pasi shumica e ankesave i përkasin vlerave deri në 300,000 euro, kjo nënkupton se shumica e ankesave shqyrtohen nga panele individuale. 8. Megjithatë, ndryshimet në rregulloren e punës nuk kanë rezultuar me rritje të efikasitetit të punës së paneleve shqyrtuese. 9. Ndryshimet në rregulloren e punës janë bërë në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, pasi ka pasur mungesë të plotë të transparencës dhe nuk janë përfshirë palët e interesuara në këtë proces. 10. Është shfaqur mungesë e koordinimit mes zyrave dhe departamenteve", ka deklaruar Hoti.

## Anulohen seancat për rastin Taçi dhe të tjerët, gjyqi rifillon më 15 janar 2024

HAGË, 12 DHJETOR - Me kërkesë të mbrojtjes së Kadri Veselit, Gjykata Speciale ka vendosur që seancat për rastin Taçi dhe të tjerët t'i shtyjë deri më 15 janar 2024. Njoftimin e ka bërë vetë Gjykata Speciale, duke treguar se kjo kërkesë ka ardhur pas vdekjes së avokatit Andrew Strong, që

ka qenë pjesë e ekipit mbrojtës. Si rezultat janë anuluar seancat e kësaj jave dhe gjyqi do të rifillojë pas pushimit dimëror më 15 janar 2024. "Rasti Taçi dhe të tjerët shtyhet për vitin e ardhshëm. Mbrojtja e Kadri Veselit në fillim të seancës së sotme kërkoi shtyrjen e

seancave këtë javë për shkak të vdekjes së fundit të anëtarit të saj Andrew Strong. Paneli e pranoi kërkesën dhe anuloi pjesën tjetër të seancave të kësaj jave. Gjyqi do të rifillojë pas pushimit dimëror më 15 janar 2024", thuhet në njoftimin e Gjykatës Speciale.



# “Dikush të na shpjegojë se çfarë do të thotë kontrata”: Veriu në dilemë se a do ta paguajë rrymën

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kompania “Elektrosever” mund ta fillojë punën, kanë thënë për “Radion Evropa e Lirë” nga Kompania për Shpërndarje të Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS), që në praktikë do të thotë furnizim me energji elektrike për komunitat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

“Elektrosever”-i është në pronësi të kompanisë energjetike të Serbisë - EPS (Elektroprivreda Srbije), por në Kosovë është themeluar sipas ligjeve vendore. Ajo buron nga marrëveshja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për energjinë, e arritur në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve.

Bashkimi Evropian, i cili ndërmjetëson dialogun, më 9 dhjetor njoftoi se “Elektrosever”-i dhe KEDS-i kanë nënshkruar një kontratë komerciale për energjinë. “Ky është një hap i rëndësishëm drejt zbatimit të Udhërrëfyesit për Energjinë dhe drejt normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë”, shkroi i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Mirosllav Lajçak, në rrjetin social “X”.

Ndërkohë, më 11 dhjetor, zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se nënshkrimi i kontratës komerciale ndërmjet KEDS-it dhe “Elektrosever”-it nënkupton një hap drejt normalizimit të furnizimit me energji elektrike në katër komuna në veri, por edhe pagesës së faturave.

Qytetarët e Mitrovicës së Veriut, Leposaviqit, Zveçanit dhe Zubin Potokut nuk i kanë paguar faturat për energjinë e konsumuar që nga viti 1999.

## Çfarë do të thotë kontrata e nënshkruar?

Në një përgjigje me shkrim për “Radion Evropa e Lirë”, KEDS-i thotë se me nënshkrimin e kësaj kontrate, “Elektrosever”-i mund ta fillojë furnizimin me energji elektrike në veri të Kosovës. “Këtë e mundësojnë kontratat e nënshkruara ndërmjet KEDS-it dhe “Elektrosever”-it, së bashku me rolet dhe përgjegjësitë e rregulluara të secilës palë, në përputhje me legjislacionin parësor dhe atë dytësor që zbatohen në Republikën e Kosovës”, tha zëdhënësi i KEDS-it, Lulzim Krasniqi.

Ai, po ashtu, shtoi se kontrata komerciale është nënshkruar në bazë të marrëveshjeve të arritura paraprakisht në kuadër të dialogut, dhe se “Elektrosever”-i, “si nënkontraktues i KEDS-it, duhet ta përmbushë obligimin e kontraktimit të shërbimeve të shpërndarjes dhe furnizimit, në bazë të licencës së furnizuesit në veri të Kosovës”. “Kontrata e nënshkruar me KEDS-in rregullon përdorimin e rrjetit të shpërndarjes



sipas kontratës për kycje, sikurse edhe për furnizuesit e tjerë aktivë në Kosovë”, thotë Krasniqi. Megjithatë, nga kjo kompani nuk janë përgjigjur qartë në pyetjen se a do të thotë kjo se qytetarët në veri do të fillojnë t’i paguajnë faturat e energjisë elektrike pas më shumë se dy dekadash.

Përgjigjen për këtë pyetje e ka dhënë zëvendëskryeministri i Kosovës dhe kryenegociatori në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi. “Tash duhet të ecet tutje edhe me hapat e tjerë të nevojshëm për t’i dhënë fund pas më shumë se 20 vjetësh, ilegalitetit në mospagesë të rrymës”, ka shkruar Bislimi në llogarinë e tij në “Facebook”.

## Çfarë thonë qytetarët?

Mirjana nga Mitrovica e Veriut, komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës, nuk e di se çfarë do të thotë në praktikë nënshkrimi i kontratës komerciale ndërmjet kompanisë serbe “Elektrosever” dhe KEDS-it të Kosovës. “Ne jemi të hutuar, së pari unë, se çfarë do të thotë kjo për ne. Me kë e nënshkruajmë kontratën, kur do të [fillojmë] ta paguajmë energjinë elektrike? Mendoj se është e rëndësishme që dikush t’i drejtohet publikut, të shpjegojë në mënyrë të thjeshtë se çfarë do të ndodhë me rrymën”, tha Mirjana në një prononcim për “Radion Evropa e Lirë”. “Nuk ia kam idenë se çfarë do të jetë”, tha një tjetër banor i Mitrovicës së Veriut, i cili kërkoi që emri dhe mbiemri i tij të mos përmendet publikisht. Sipas tij, “populli është mashtruar” dhe beson se askush nuk e di se çfarë do të thotë për qytetarët e veriut nënshkrimi i kontratës komerciale

me KEDS-in.

Ndërkaq, Nenadi theksoi se “është koha të fillojmë ta paguajmë energjinë elektrike”. “Nëse duam ta shikojmë nga një anë, të mos e paguash energjinë elektrike për një çerek shekulli, nuk ka kështu askund në botë. Në anën tjetër, do të shohim se çfarë ofrojnë ato kontrata, a do të ketë privilegje, a do të fshihen borxhet e vjetra dhe si do të bëhet pagesa”, tha Nenadi për “Radion Evropa e Lirë”.

Borxhet për energjinë elektrike të konsumuar në veri të Kosovës nga viti 2017 mbulohen nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (KOSTT), gjegjësisht nga Qeveria e Kosovës. Deri atëherë borxhin për veriun e paguanin qytetarët e Kosovës nga komunitat e tjera në jug të Ibrit, në mënyrë paushall, kështu që faturat e tyre ishin më të larta për 3.5 për qind.

## Çfarë thonë nga Serbia?

“REL”-i i është drejtuar kompanisë publike serbe “Elektroprivreda Srbije” (EPS), nën pronësinë e së cilës është “Elektrosever”-i, me pyetjen se çfarë hapash konkretë parashihet kontrata komerciale me KEDS-in dhe çfarë saktësisht nënkupton në praktikë. Mirëpo deri në publikimin e këtij artikulli përgjigja nuk ka ardhur. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha më 10 dhjetor se një nga hapat e ardhshëm është që kompania “Elektrosever” të nënshkruajë një “kontratë me popullatën”, pra me konsumatorët në veri të Kosovës. Ai theksoi se “ende po i shikojmë detajet” e marrëveshjes ndërmjet kompanive “Elektrosever” dhe KEDS, por se qëllimi kryesor i Beogradit zyrtar është që “të

shmanget çdo mundësi që populli në veri të Kosovës të mbetet pa energji elektrike”. “Fundja, kjo është gjëja më e rëndësishme për ne”, tha Vuçiqi.

Ai shtoi se marrëveshja ndërmjet “Elektrosever”-it dhe KEDS-it “nuk e paragjykon çështjen e pronës”, por nuk ka specifikuar se për cilën pronë bëhet fjalë, as çfarë do të thotë konkretisht kjo. As KEDS-i i Kosovës nuk ka dhënë përgjigje konkrete lidhur me pyetjen për pronën.

## Çfarë parashohin marrëveshjet për energjinë?

Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen e parë për energjinë në vitin 2013. Ndër të tjera, ajo parashihet formimin e kompanisë “Elektrosever”, e cila do t’i furnizojë konsumatorët me energji elektrike, do të ofrojë shërbime të shpërndarjes, gjegjësisht dhënie dhe mbledhjen e faturave, si dhe mirëmbajtjen dhe lidhjen fizike të konsumatorëve të rinj.

Më pas, në vitin 2015, janë miratuar konkluzionet për zbatimin e marrëveshjes për energjinë, të cilat parashikojnë hapa konkretë për themelimin e “Elektrosever”-it sipas ligjeve të Kosovës. Por, në qershor të vitit 2022, për shkak të vonësës në zbatimin e këtyre marrëveshjeve, me ndërmjetësimin e BE-së, u miratua Udhërrëfyesi për zbatimin e marrëveshjes për energjinë.

Ky udhërrëfyes parashihte, gjithashtu, hapa të qartë në drejtim të zbatimit të marrëveshjes, të cilët është dashur të bëhen brenda 100 ditëve, por që nuk u realizuan brenda atij afati.

Kosova dhe Serbia ia faturonin

përgjegjësinë njëra-tjetër, ndërsa Bashkimi Evropian, më herët, deklaroi se vonesa ishte shkaktuar për “arsye teknike”.

Udhërrëfyesi për zbatimin e marrëveshjes për energjinë parashihet që kompania “Elektrosever” të marrë licencë për të punuar në Kosovë dhe të nënshkruajë marrëveshje teknike me Kompaninë e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) dhe Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë (KOSTT).

Më pas, “Elektrosever”-it i është dashur t’i marrë kodet identifikuese për kryerjen e aktiviteteve, ndërkaq që KEDS-i dhe KOSTT-i të kenë qasje në nënstacionin e Vallaçit në veri të Kosovës, si dhe në infrastrukturën tjetër për shpërndarjen e energjisë elektrike. Po ashtu, në Udhërrëfyesin për zbatimin e marrëveshjeve energjetike thuhet se KEDS-i dhe KOSTT-i, në konsultim me “Elektrosever”-in, duhet të dorëzojnë në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) planin investues, kostot e mirëmbajtjes, si dhe humbjet në rrjet, bazuar në analizën e infrastrukturës ekzistuese.

Shumica e pikave nga Udhërrëfyesi për zbatimin e marrëveshjeve për energjinë janë zbatuar. Pas nënshkrimit të marrëveshjeve teknike, në tetor të vitit të kaluar, KOSTT-i njoftoi se është i gatshëm të investojë në nënstacionin e Vallaçit.

Ky nënstacion në veri të Kosovës siguron pjesën më të madhe të energjisë elektrike për qytetarët e veriut të vendit si dhe furnizon me energji hidrocentralin në liqenin e Ujmanit (Gazivodës).



# Analisti britanik: Evropa, përgatitje për luftë para se të jetë tepër vonë!

Krahu i Trump i Partisë Republikane, beson autori, nuk pasqyron atë që dëshiron shumica e amerikanëve



Shtetet anëtare të NATO-s në Evropë po përballen me një krizë të madhe – Rusia dhe Kina po armatosen me shpejtësi, me Moskën që po kalon në një ekonomi luftime në shkallë të plotë. Edhe pse SHBA është ende më e fortë se të dyja vendet së bashku dhe rezistenca heroike e Ukrainës ka frenuar forcat e Kremlinit, të dyja këto mund të ndryshojnë shumë shpejt, shkruan autori Lewis Page në komentën e tij për britaniken The Telegraph.

Më keq, ka pasur një ndryshim politik në Amerikë. Krahu i Trump i Partisë Republikane, beson autori, nuk pasqyron atë që dëshiron shumica e amerikanëve – por, në fund të fundit, Donald Trump është bërë president më parë dhe mund të bëhet sërish president, për shkak të kandidatëve të tmerrshëm demokratë. Politikanët republikanë të linjës së ashpër që aktualisht bllokojnë ndihmën për Ukrainën nuk flasin për shumicën e amerikanëve, por numrat në Kapitol Hill u japin atyre ndikim joproporcional.

Ajo që kuptohet më pak është se presidenti Joe Biden është gjithashtu një aleat jo i besueshëm. Ai ka refuzuar

qëllimisht t'i japë Ukrainës një armë që mund të rrezojë urën e Kerçit (Krimë) që lidh kontinentin rus me Krimenë – potencialisht një goditje vendimtare kundër Kremlinit – sepse i frikësohet kartwës bërthamore të Putinit. Biden nuk i dërgoi as tanket derisa Britania e "shtynte" atë me vendimin e saj për të dorëzuar, sipas Page. Ai gjithashtu, sipas autorit, nuk përfaqëson amerikanët, edhe pse është komandant i përgjithshëm.

Skenari i makthit është ai në të cilin Rusia arrin të detyrojë t'i japë fund luftimeve në Ukrainë dhe vazhdon armatimin dhe mobilizimin masiv që është duke u zhvilluar. Në planin afatgjatë, ekonomia ruse do të shembet nën presionin ashtu si ajo që ndodhi me Bashkimin Sovjetik. Por në afat të shkurtër – besojnë polakët në vetëm tre vjet – ushtria ruse mund të kthehet, më e madhe dhe e ngurtësuar nga beteja. Dhe pastaj Kina lëviz kundër Tajvanit, ndërsa Vladimir Putin lëviz kundër NATO-s, parashikon autori.

Nëse SHBA-ja do të ishte e vendosur dhe e gatshme të përballonte peshën kryesore të luftimeve, ndoshta mund t'i

fitonte të dyja luftërat menjëherë. Por, siç mund të shihet, presidenti i ardhshëm mund të mos jetë i vendosur apo i gatshëm ta bëjë këtë, ndaj lind pyetja se çfarë do të thotë kjo për vendet në këtë anë të Atlantikut.

Siç shprehet autori, këtu vlen shprehja e vjetër: "Nëse do paqe, përgatitu për luftë". Britania dhe Evropa më në fund duhet të kujdesen për mbrojtjen e tyre në vend që të shpenzojnë paratë e tyre për shtetet e fryra të mirëqenies dhe të mbështeten te Amerika për sigurinë e tyre. Megjithatë, këtu nuk bëhet fjalë vetëm për shpenzime më të larta në mbrojtje, por edhe për shpenzime efikase, siç u theksua. Në të gjithë botën perëndimore, ish-oficerët ushtarakë argumentojnë se situata në Ukrainë do të thotë se Evropa ka nevojë për sasi masive tankesh, armësh dhe granatash.

Evropa ka nevojë për sisteme dhe armë të ndryshme – kryesisht raketa dhe dronë të llojeve të ndryshme. Disa e shohin nevojën në rritje – anëmbanë Evropës dhe Britanisë, kompanitë e armëve fjalë për fjalë po ngërthejnë idenë se qeveritë e tyre do të investojnë shumë të mëdha në zhvillimin e

teknologjive të ndryshme të armëve që ka vetëm SHBA. Politika britanike nga më parë ishte se ajo do të fillonte edhe para sulmit rus në Ukrainë, përmes projekteve të tilla si programi për zhvillimin e avionit luftarak të ardhshëm stealth "Tempest" (i cili duhet të jetë gati deri në vitin 2035 dhe të bëjë që do të formojë Polonia, të cilën autori e quan të arsyeshme në këtë kuptim – e cila është shumë më e përqendruar në këtë pasi kufizohet me Rusinë – nuk e ndërtoi një industri ushtarake nga e para. Polakët, siç u tha, thjesht blenë një numër të madh tankesh – të cilat kanë shumë më tepër kuptim për Poloninë sesa, për shembull, për britanikët – nga Koreja e Jugut, dhe raketa të fuqishme nga SHBA. Nëse Britania, për shembull, vendos se ka nevojë për tanke, ajo thjesht duhet t'i blejë ato nga prodhues të mirë si Koreja e Jugut, Gjermania ose Izraeli, në vend që të përpiqet të ringjallë industrinë e saj të tankeve që po vdes, siç është bërë deri më tani.

Kur bëhet fjalë për Britaninë, thuhet se sigurisht që ka gjera që vendi do të duhet t'i ndërtojë vetë, për shembull nëndetëset e veta, pasi SHBA planifikon të ndërtojë

sasi të mjaftueshme të këtyre anijeve për veten dhe Australinë. Megjithatë, ata duhet të jenë të armatosur me armë amerikane. Është e njëjta gjë me mini-nëndetëset dhe vendi prodhon gjithashtu disa armë të tjera të klasit botëror, si pushkë snajper ose mjete të blinduara të të gjithë terrenit.

Por në çdo rast, mesazhi i autorit është se ne duhet të ndalojmë së provuari të bëjmë gjithçka vetë dhe të përfshihemi në përpjekje shumëkombëshe për të përsëritur gjëra që Britania thjesht mund t'i blejë. Ato përpjekje, beson ai, gjithmonë përfundojnë në katastrofë, duke treguar për projektet Eurofighter, Sea Viper dhe Merlin. Kur blini jashtë shtetit, ndaloni të ndërhyri në industrinë britanike dhe të hidhni në erë produkte krejtësisht të mira, siç ka ndodhur më parë.

Me pak fjalë, si polakët, pohon autori, ne duhet të merremi seriozisht. Ukrainasit po blejnë Evropën dhe Britaninë kohë të çmuar, me një çmim të tmerrshëm në gjak. Britania duhet t'i armatosë dhe të armatohet deri në dhembë, pa krijuar vende pune për vete – dhe kjo duhet bërë para se të jetë tepër vonë.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Ademi: Në janar ose shkurt vendosim për trajnerin e ri

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Gianni De Biasi e Ilir Daja ishin dy nga emrat më të përfolur për ta marrë drejtimin e Përfaqësueses së Kosovës në futboll pas shkarkimit të Primoz Glihas. Megjithatë, Agim Ademi ka shuar zërat për një emërim të njërit prej dyshes De Biasi - Daja. Në një intervistë për "Panorama Sport", Agim Ademi ka deklaruar se ish-trajneri i kombëtares shqiptare, De Biasi, nuk është opsion për stolin e Kosovës. Ai ka folur edhe për trajnerin shqiptar Ilir Daja. "Deri nga fundi i janarit fillimi i shkurtit nuk kemi ndër mend të zyrtarizojmë ndonjë trajner. Jemi në bisedime me disa, por nuk kemi asnjë emër konkret deri tani. Të shohim më tej. De Biasi është ofruar. Na kanë sugjeruar njerëz të futbollit. I kemi thënë që e respektojmë shumë, por në këto

momente nuk e kemi opsion për stolin e Kosovës", ka thënë Ademi. Sa i përket Ilir Dajës, Agim Ademi ka thënë se Kosova duhet të ketë më shumë trajnerë si ai. "Si Ilir Daja na duhen edhe nja 3-4 trajnerë të tjerë në Kosovë", ka thënë Ademi. Kosova është pa trajner që nga përfundimi i ciklit kualifikues për Kampionatin Evropian. I pari i shtëpisë së futbollit kosovar ka deklaruar se deri më tani kanë konkurruar rreth 27 kandidatë.

## 'AS': Moreno ka ofertë nga Kosova

Krahas ofertës së Kosovës, trajneri spanjoll Robert Moreno është duke shqyrtuar edhe dy oferta të tjera nga

klubet evropiane. Trajneri 46-vjeçar pritet të marrë një vendim për të ardhmen e tij gjatë ditëve në vazhdim. Moreno ka marrë oferta për të drejtuar klubet si Sochi në Rusi dhe Adana Demirspor në Turqi, ka raportuar e përditshmja spanjolle "AS". Ish-trajneri i kombëtares spanjolle ka zhvilluar bashkëbisedime të ndryshme me drejtuesit e klubeve si dhe me kryetarin e FFK-së, Agim Ademi, ndërsa pritet të marrë një vendim final për të ardhmen e tij gjatë ditëve në vazhdim. Sipas raportimit nga "AS", Moreno ka pak gjasa ta pranojë ofertën e Kosovës. Opsioni i drejtimit të një klubi po shihet si më i mundshëm për teknikun spanjoll sesa drejtimi i kombëtares. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që ai ta pranojë ofertën e FFK-së.



# Gjilani - Prishtina, ndeshja kryesore në 1/8 e Kupës

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Në praninë e Komisionit të Garave, kryetari Abdyl Bellopoja e anëtarit Isak Ejupi, administratorit të Superligës dhe Ligës së Parë, Agron Shosholli, si dhe përfaqësuesve të klubeve, është bërë tërheqja e shortit për 1/8 të Kupës së Kosovës në Futboll. Në këtë rreth të garave janë të përfshira 16 skuadra, të cilat më 3 dhe 4 shkurt do të përballen për kualifikim tutje. Ndeshja kryesor e 1/8 së finales së Kupës është ajo në mes të Gjilanit dhe Prishtinës. Llapi ka punë me Trepçën '89, kurse kampioni i

Superligës, Ballkani, do të përballen me Vllaznimi.

## ÇIFTET PAS TËRHEQJES SË SHORTIT:

- Trepça '89 - Llapi
- Gjilani - Prishtina
- Drita - Rilindja 74
- Vjosa - 2 Korriku
- Feronikeli - Malisheva
- Suhareka - Prishtina e re
- Ballkani - Vllaznimi
- Dukagjini - Dinamo



## SHKURT

### Shirko përforcon Sigal Prishtinën

KB Sigal Prishtina e ka zyrtarizuar transferimin e Henrik Shirkos. Basketbollisti kroat u largua pak ditë më parë nga Golden Eagle Ylli. Basketbollisti në fjalë kishte qëndruar në klubin suharekas dy vjet dhe e kishte fituar titullin e kampionit të Kosovës. Kryeqytetasit i uruan mirëseardhje basketbollistit kualitativ, me të cilin synojnë që bashkërisht të arrijnë suksese në këtë edicion si në garat vendore ashtu edhe në Ligën Ballkanike.

### Dy klube italiane në garë për Hoxhën

Ish-futbollisti i Ballkanit, njëherësh Slaven Belupon, Arbër Hoxha, është duke kaluar një sezon fantastik në Kroaci dhe kjo ka bërë që klubet e njohura t'ia vënë syrin atij. Interesim për Hoxhën ka shfaqur Dinamo Zagrebi, kurse tash garës për të i janë shtuar edhe dy skuadra nga Seria A. Sipas "Sportske Jutarnji", interesim për Hoxhën kanë shfaqur klubet elitare italiane, Torino dhe Monza. Hoxha i ka realizuar 5 gola dhe i ka dhuruar 3 asistime në pjesën e parë të sezonit, ndonëse u injorua nga Kombëtarja e Kosovës në këtë vit. Nga shitja e Hoxhës, Slaven Belupo mund t'i fitojë 2-3 milionë euro.

### Nuhiu largohet nga Shkëndija e Tetovës

Ardian Nuhiu nuk është më trajner i Shkëndijës së Tetovës. Ekipi nga Maqedonia e Veriut ka njoftuar të martën se ka ndërprerë bashkëpunimin me marrëveshje të dyanshme me trajnerin Nuhiu. Në njoftimin e klubit thuhet se ky vendim ka ardhur për shkak se është e nevojshme të bëhen ndryshime që do të sjellin një frymë të re dhe drejtim të ri. Nuhiun e kanë falënderuar për punën dhe kontributin e dhënë, ndërsa i kanë dëshiruar suksese në vazhdim të karrierës. Po ashtu, së bashku me Nuhiun është larguar edhe stafi i tij nga Shkëndija e Tetovës. Nuhiu mori drejtimin e Shkëndijës para fillimit të këtij edicioni dhe kishte kontratë deri në verën e vitit 2025. Aktualisht Shkëndija zë vendin e tretë në elitën e futbollit të Maqedonisë së Veriut. Pas 18 xhirove të zhvilluara, ka tubuar 35 pikë, katër më pak se Struga që zë vendin e parë. Para Shkëndijës, Nuhiu ka qenë trajner edhe te Drita e Gjilanit dhe Shkupi.

## Verstappeni: Mund të thyej edhe shumë rekorde të tjera të Hamiltonit

**HASSELT, 12 DHJETOR** - Pasi fitoi titullin e parë kampion bote në Formula 1 në një duel "rrotë më rrotë" me Lewis Hamiltonin në garën e fundit, piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappeni, fitoi edhe dy tituj të tjerë. Këtë herë më të lehtë, duke dueluar me veten, aq sa këtë vit vendosi rekordin e 19 fitoreve

sezonale. I pyetur nëse i mungojnë sfidat e dikurshme me Hamiltonin, piloti holandez është përgjigjur: "Nuk më mungojnë aspak duelet me të. Sigurisht që i vlerësoj shumë sfidat që kemi pasur në të shkuarën, por jam i kënaqur për mënyrën se si shkoi ky sezon. I vlerësoj sukseset që mund të festoj

bashkë me skuadrën". Këtë vit Verstappeni theu mjaft rekorde në Formula 1, përfshirë edhe atë të 1003 xhirove në krye të garave në një sezon të vetëm. Holandezi ka një seri prej 41 garash radhazi që renditet në "top-10" më të mirët, ndërkohë që ky rekord mbahet nga Hamiltoni, me 48 gara në

zonën e pikëve. "Ndoshta mund ta mposht këtë rekord dhe shumë të tjerë që mban ai. Vizioni im ka ndryshuar dhe unë përpiqem gjithnjë të fitoj kur kam mundësinë ta bëjë këtë gjë", u shpreh Max Verstappeni, që shihet si favorit edhe për sezonin e



ardhshëm. Hamiltoni ka rekordin e 7 titujve kampion bote në Formula 1 bashkë me Michael Schumacherin.

## Broja: Lëndimi më ndryshoi mentalisht, por dua të ec përpara

**LONDËR, 12 DHJETOR** - Armando Broja ende nuk ka mundur të rikthehet në formën e tij optimale kur kanë kaluar disa muaj nga lëndimi i rëndë që pësoi ndaj Aston Villas. Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë ka dhënë një intervistë për faqen e Chelseat, ku tregon edhe vuajtjet e mëdha që ka kaluar. "Gjithçka po shkonte shumë mirë, më pas erdhi ndeshja kundër Aston Vilës. Hyra për ta marrë topin, ai më kaloi dhe gjuri im shkoi nga brenda. Sapo u bë ai kontakti fillestar, e kuptova menjëherë se diçka nuk shkonte. Kisha shumë dhimbje. Gjuri më rrihte, megjithëse nuk mund ta ndieja në fillim, sepse ishte një tronditje e madhe. Nuk kisha pasur kurrë një dëmtim kaq të madh më parë. Isha konfuz, nuk isha i sigurt se çfarë po ndodhte, po bërtisja. Jam i sigurt që më dëgjoi gjithë stadiumi. U ktheva në dhomën e zhveshjes pasi u largova me barelë. Të nesërmen shkova direkt për të bërë një skaner. Më thanë se kisha çarë meniskun. Prindërit e mi ishin aty dhe ishte një tronditje e madhe. Ishte shkatërruese", ka thënë Broja. Më pas Broja foli edhe për periudhën e riaftësimit, duke treguar se nuk ishte periudhë aspak e vështirë. "Muajt e parë ishin të vështirë. Nuk e kuptova se kishte




kaq shumë faza të rehabilitimit që duhet të kaloja. Fillova të mos ecja dot dhe isha i lidhur në shtrat për njëfarë kohe. Më duhej të mësoja se si të ecja përsëri pothuajse nga e para. Isha me paterica. Fillova me dy, më pas arita në një, më pas m'u desh të provoja të mbaja peshë në gjurin tim. Më duhej të rimësoja të gjithë filozofinë e ecjes. Kur fillova të ecja ende nuk mund ta përkulja ose zgjasja plotësisht gjurin. Sapo e kalova këtë dhe munda ta përkulja gjurin, mendoja se mund ta filloja stërvitjen, por ditën e parë që dola jashtë e ndjeva që nuk isha gati", ka shtuar Broja. "Deri në shtator të këtij viti unë isha jashtë stërvitjes me

grupin. Ishte një periudhë e gjatë dhe një rrugë malore. E dija që lojtarët e tjerë e kishin kaluar të njëjtin dëmtim më parë si Ben Chilwell. Vetëm mendoja për këtë dhe u përpoqa të luftoja. U detyrohem një meritë të madhe mjekëve dhe stafit mjekësor të Chelseas. Ata më kanë ndihmuar vazhdimisht çdo ditë për të më rikthyer në pozicionin në të cilin jam tani. Nuk do ta kisha bërë pa ata, prindërit e mi dhe shokët e skuadrës", ka deklaruar sulmuesi kuqezi. Në fund Broja foli edhe për synimet që kishte, duke paralajmëruar se synim e ka të kontribuojë sa më shumë në sukseset e skuadrës. "Patë një ndikim të madh në jetën time, nga ana fizike dhe mendërisht. Më ndryshoi mendërisht, dhe mënyrën sesi mendoj për t'u marrë me gjërat. Ishte një periudhë e vështirë, por jam shumë i lumtur që ka kaluar. Tani dua të ec përpara dhe të vazhdoj. Ndihej më mirë se kurrë dhe tani gjuri im është kthyer pothuajse si ishte. Ndihej mirë dhe i lumtur. Mezi pres tani që të shpresoj të marr më shumë mundësi dhe të vazhdoj që anej. Dua ta ndihmoj skuadrën sa më shumë që të jetë e mundur dhe ndihem gati për ta bërë këtë", ka deklaruar Broja.

## Denveri dhe Miami triumfojnë jashtë fushës, Milwaukee fiton pas kohës shtesë

**ATLANTA, 12 DHJETOR** - Philadelphia qëndron në grupin e skuadrave pretendente në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 146-141 ndaj Washingtonit në një ndeshje spektakolare. Joel Embiid me 34 pikë e 11 rebounde ishte shënuesi më i mirë i ndeshjes. Fituan edhe kampionët e Denverit, që mposhtën me rezultat 129-121 Atlantën jashtë fushës, ndeshje ku Murray e Jokiqi realizuan 54 pikë së bashku. Skuadra e Dallasit, falë 35 pikëve të Donqiqit, mundi Memphisin (120-113), duke korrur një fitore të madhe jashtë fushës. Minnesota ruan kreun e renditjes në Perëndim pavarësisht humbjes 121-107 në fushën e New Orleansit.



Për vendasit u dallua Zion Williamson, autor i 36 pikëve. Fitoi skuadra e Miamit, që falë 24 pikëve të Robinsonit dhe 23 të Butlerit, mundi me rezultat 116-114 Charlotten. Ekipi i Clippersit mposhti me rezultat 132-127 Portlandin, ndeshje ku dallimin e bëri Leonardo me 34 pikë. Moment

të mirë po kalon Oklahoma, në vendin e dytë në Perëndim, duke fituar me shifrat 134-120 ndaj Utah Jazzit, sfidë ku u dallua Shai me 30 pikë.

### REZULTATET

CHARLOTTE - MIAMI	114-116
DETROIT - INDIANA	123-131
ORLANDO - CLEVELAND	104-94
PHILADELPHIA - WASHINGTON	146-141
ATLANTA - DENVER	122-129
NEW YORK - TORONTO	136-130
HOUSTON - SAN ANTONIO	93-82
MEMPHIS - DALLAS	113-120
MILWAUKEE - CHICAGO	133-129
NEW ORLEANS - MINNESOTA	121-107
OKLAHOMA - UTAH JAZZ	134-120
SACRAMENTO - BROOKLYN	131-118
CLIPPERS - PORTLAND	132-127

## Messi më 29 janar sfidon Ronaldon

Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo, dy rivalët e përjetshëm, dy nga lojtarët më të mëdhenj të të gjithë kohëve, do të përballen sërish ndërmjet tyre, mbase për herë

të fundit. Ka qenë klubi i Inter Miamit që ka njoftuar këtë përballje mes dy titanëve teksa bën publike agjendën për fazën përgatitore, agjendën e miqësoreve. Më 29 janar Inter

Miami do të luajë kundër Al Hilalit por, për fat të keq, Messi nuk do të ketë mundësi të luajë kundër mikut të tij Neymar. Braziliiani e ka mbyllur prej kohësh sezonin.

Më pas, më 2 shkurt, në Riyad të Arabisë Saudite do të luhet miqësorja Al Nassr-Inter Miami, Ronaldo vs Messi. 13 "Topa të Artë" në fushë janë një arsye e fortë për t'i joshur

tifozët. Pavarësisht se janë ndarë prej kohësh, Ronaldo - Messi mbetet një sfidë e përjetshme, ndërsa tifozët kanë luksin t'i shohin edhe një herë kundër njëri-tjetrit.

### SHKURT

#### Sylvinho në mesin e trajnerëve më të mirë në botë

Kombëtarja e Shqipërisë në futboll e ka siguruar për herën e dytë në histori kualifikimin në Kampionatin Evropian. "Kuqezinjtë" do të jenë pjesë e "Euro 2024" që vitin tjetër do të mbahet në Gjermani. E padyshim një prej "fajtorëve" për suksesin e arritur është trajneri Sylvinho. Braziliiani për këtë shkak është renditur edhe në mesin e selektorëve më të mirë në botë. IFFHS-ja, Federata për Histori dhe Statistika, e renditi trajnerin e kombëtares në vendin e pestë për vitin 2023. Sylvinho ka lënë prapa emra të mëdhenj, përfshirë edhe atë të Argentinës, Lionel Scaloni. Përpara brazilianit gjenden vetëm Luis de la Fuente i Spanjës, Steve Clarke i Skocisë, Didier Deschamps i Francës dhe Gareth Southgate i Anglisë.

#### Ancelotti: Modriqi, Kroosi dhe Nacho vendosin vetë për të ardhmen

Trajneri i Real Madridit, Carlo Ancelotti, ka thënë se Luka Modriq dhe Toni Kroos si dhe mbrojtësi Nacho do të largohen nga klubi vetëm atëherë kur ata e konsiderojnë se duhet ta bëjnë një gjë të tillë. Strategu italian që të tre futbollistët i ka quajtur legjenda të klubit madrilen. "Modriq, Kroos e Nacho do të vendosin për të ardhmen e tyre kur të duan ata. Legjendat e këtij klubi vendosin vetë se çka duan të bëjnë. Klubi e ka një respekt të madh për këta lojtarë, të cilët e kanë fituar të drejtën të vendosin për të ardhmen e tyre", ka thënë Ancelotti.

#### Osimhen fiton 'Topin e Artë' afrikan

Viti 2023 është në ditët e fundit dhe në këtë moment bëhet edhe një pjesë e bilanceve për vitin që lamë pas. Së fundmi në Afrikë është zgjedhur edhe lojtari më i mirë i vitit 2023. Sulmuesi nigerian i Napolit, Victor Osimhen, ka marrë "Topin e Artë" afrikan, që i është dhënë 24-vjeçarit nga Konfederata Afrikane e Futbollit. Pavarësisht se gjatë këtij viti Osimhen ka vuajtur nga dëmtimet, nigeriani fitoi titullin kampion të Serisë A me Napolin, duke qenë një nga emrat kryesorë të skuadrës që triumfoi në Itali. Duke lënë pas emra si Onana, Hakimi, Mbemba, Koulibaly, Partey, Anguissa, Kudus, Amrabat, Mane, Salah.

#### Davies, gati t'i bashkohet Realit

Mbrojtësi Alphonso Davies ka refuzuar rinovimin e kontratës me Bayern Munchen dhe, sipas medieve në Spanjë, ai është i gatshëm t'i bashkohet Real Madridit. "Bavarezët" kërkojnë 50 milionë euro për ta lënë Daviesin të largohet nga Bundesliga, mirëpo në një situatë të tillë duket se çmimi mund të ulet edhe më shumë për anësorin e mbrojtjes. 23-vjeçari është pjesë e Bayernit nga viti 2019 dhe që nga ajo kohë ka realizuar 118 ndeshje.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

### 'BAB CLUB' SHPALL TË PAVLEFSHME DY ARKA FISKALE

Biznesi N.Sh.H. "Bab Club" me numër unik identifikues: 811517244 shpall të pavlefshme arkat fiskale me numër: GK52202697 dhe GK52203605.

- Labinot Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën me nr. 108/2021 të lëshuar nga Qendra e Aftësimi Profesional në Mitrovicë, kursi Zdrukthtari.

- Osman Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Mimoza Bibaj komuna e Malishevës, shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Skyfer Haxhija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Vjollca Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.I sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë drejtimi Juridik.

- Arbnor Dervishaj shpall të pavlefshme dëftesat Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Naim Hasani shpall të pavlefshme diplomën Q.K."11 Marsi" Prizren.

- Lavdim Ibrahim shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të

volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

